



Vlerësimi i nëntë mbi gjendjen e pakicave etnike në Kosovë **(periudha kohore prej shtatorit të v. 2001 deri në mars të v. 2002)**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky vlerësim i përbashkët, i nënti me radhë, dhe i punuar nga OSBE-ja dhe UNHCR-ja, mbi gjendjen e pakicave në Kosovë, koïncidon me përvjetorin e tretë të arritjes në Kosovë të UNMIK-ut dhe KFOR-it për të instaluar praninë civile dhe ushtarake në të. Gjatë asaj kohe, ne kemi përcjellur zhvillimin e gjendjes së pakicave, duke vënë theksin në problemet të cilat vazhdojnë ta bëjnë jetën e përditshme, për shumë pjestarë të pakicave, si jashtëzakonisht të pasigurtë. Ky vlerësimi, mbulon një periudhë gjashtëmujore mjaft të rëndësishme për Kosovën, e cila shënohet me tranzicionin i cili kishte filluar të zhvillohej pas mbajtjes së zgjedhjeve me 17 nëntor 2001 dhe krijimit pasues të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, përfshirë këtu Parlamentin e Kosovës të përbërë nga të gjitha grupet etnike, e gjithashtu Qeverinë. Këtë periudhë kohore e karakterizon gjithashtu edhe shkalla në rënje e sipër e kriminalitetit të përgjithshëm dhe krimeve të dhunshme në Kosovë. Të gjitha analizat e mëtutjeshme në këtë vlerësim do të kufizohen në konstatimet e sipër përmendura.

Vlerësimi paraprak i përbashkët dhe i teti sipas radhës, kishte vërejtur një ulje graduale të incidenteve të rënda të sigurisë, duke paraqitur një tentativë drejt stabilizimit të përgjithshëm të shumë komuniteteve të pakicave (së paku sa i përket sigurisë fizike elementare) pas periudhave të mëhershme të paqëndrueshme, dhe të karakterizura me dhunën e vazhdueshme nga motivet etnike. Trendi pozitiv ka vazhduar edhe gjatë periudhës të cilën e mbulon ky vlerësim. Ne kemi vërejtur një **përmirësim gradual të sigurisë** me një ulje të vazhdueshme të frekuencës së veprave të rënda të dhunës kundër pakicave. Mëgjithatë, ne kemi vërejtur praninë e vazhdueshme të frikësimeve dhe ngacmimeve të përditshme, por edhe ato të rastit. Edhe pse më pak të shpeshta, shfaqja e sulmeve jashtëzakonisht të dhunshme dhe të motivuara etnikisht, nganjëherë rezultonte në lëndime të rënda trupore, madje edhe në humbje të jetës. Edhe pse numri i incidenteve është në rënje e sipër, pakicat vazhdojnë të frikohen nga sulmet, posaçërisht atëherë kur ata lëvizin jashtë rrethit të vendbanimit.

Ne gjithashtu kemi shqyrtuar atë që ka mbetur si njëri prej **problemeve kyçe për pakicat: liria e lëvizjes**. Vlerësimi i kësaj periudhe kohore tregon se liria e lëvizjes mebetet si çështje fundamentale e cila ndikon në mundësitë e pakicave për të jetuar një jetë normale, dhe se realizimi i lirisë së lëvizjes akoma është shumë i kufizuar për shkak të gjendjes objektive të sigurisë, por edhe perceptimeve të sigurisë. Pa lirinë e lëvizjes, qasja në shumë shërbime elementare, punësim dhe strukturat civile, vazhdon të mbetet jashtëzakonisht e vështirësuar dhe në shumë raste edhe e pamundur. Ky vlerësim vëren **një trend, në rritje e sipër, të lëvizshmërisë** së pakicave gjatë kësaj periudhe, gjë që, edhe pse inkurajuese, nuk do të duhej të shihej si sinonim i lirisë së përgjithshme të lëvizjes, gjë që mund të realizohet vetëm atëherë kur, çdo pakicë mund të udhëtoj në secilin lokalitet, përfshirë këtu edhe qendrat urbane, dhe pa ndonjë përcjellje të posaçme individuale apo kolektive dhe pa ndonjë frikë për pësim nga dhuna apo ngacmimi.

Në kontekst ne kemi analizuar **qasjen në shërbimet elementare** dhe në institucione, me një theks të veçantë në ato më të rëndësishmet, pra: **sistemin gjyqësor; arsimim; shërbimet shëndetësore dhe sociale; shërbimet publike, dhe punësimin.** Pengesat dhe vështirësitë e pakicave në realizimin e të **drejtave pronësore,** dhe në qasjen në **ndihmën për rindërtimin e shtëpive,** janë nënvizuar si probleme jetike të cilat pengojnë stabilizimin e komuniteteve të pakicave dhe kthimin e pakicave të zhvendosura. Me zgjedhjet e nëntorit të v.2001 dhe krijimin e strukturave qeveritare, ne gjithashtu kemi shqyrtuar çështjen e **pjesëmarrjes në strukturat politike dhe civile** dhe në atë të **dialogut ndëretnik.**

Një çështje tjetër që është adresuar dhe në kontekst të vetëqeverisjes në lindje e sipër në Kosovë, është ajo e pranisë dhe barrkadimit të vazhdueshëm të **strukturave paralele,** të cilat janë duke u shëndrruar në pengesë të madhe për sigurimin e qasjes në shërbimet elementare për pakicat dhe të cilat në disa raste janë duke e vazhduar izolimin e komuniteteve të pakicave. Strukturat paralele ekzistojnë dukshëm në sistemin gjyqësor, shkollor dhe shëndetësi, dhe posaçërisht për serbët, si kur është fjala për strukturat e pranuar (ambulantat dhe shkollat) por edhe ato të papranuara (gjykatat serbe) dhe të përkrahura nga autoritetet e Beogradit dhe shpeshherë edhe nga OJQ-të ndërkombëtare. Përderisa në disa raste (posaçërisht në ato të sektorit shëndetësor dhe arsimor) disa struktura paralele mbase kanë qenë dhe mund të vazhdojnë të jenë të pashmangshme, si një masë e përkohshme, për shkak të pasigurisë dhe kufizimeve të lirisë së lëvizjes, në anën tjetër, këto struktura për pakicat ofrojnë përfundimisht, shërbime të paqëndrueshme dhe të dorës së dytë dhe kufizojnë çdo formë të dialogut ndëretnik.

Shfrytëzimi i strukturave paralele nga ana e pakicave, e tërënjekë vëmendjen nga ajo që do të duhej të ishte çështje kryesore, e që është, nevoja urgjente e adresimit të shkaqeve dhe gjetja e zgjidhjeve për pamundësitë e vazhdueshme të pakicave, që të kenë qasje të drejtë në gjykata, spitale, shkolla, qendra sociale dhe shërbime tjera publike. Me rritjen e sigurisë dhe lëvizshmërisë është me rëndësi që UNMIK-u dhe strukturat e përkohshme të vetëqeverisjes, në konsultim me të gjitha komunitetet, të filloj të shiqoj se si të shkohet përpara drejt strukturave të integruara, të cilat, i marrin parasyshtë nevojat e të gjitha komuniteteve, dhe të cilat ofrojnë shërbime në baza të mos diskriminimit. **Diskriminimi është i përhapur,** dhe ekziston nevoja për ligje të qarta, sanksione dhe mjete juridike efikase, e posaçërisht të njëjtat të zbatohen përmes sistemit gjyqësor. Mund të ketë nevojë për masa të përkohshme speciale për pakicat dhe këtu mund të merren mësim nga masat e nënmarrura të cilat kanë lejuar qasjen e minoriteve në strukturat civile dhe politike, posaçërisht gjatë zgjedhjeve parlamentare.

Me krijimin e Institucioneve të Përkohëshme të Vetëqeverisjes (IPV), ne theksojmë se vlerësimi i gjendjes së pakicave kërkon jo vetëm thjeshtë vlerësimin e problemeve, por edhe të **përgjegjësiave të autoriteteve** për përmirësimin e gabimeve dhe gjetjen e zgjidhjeve. Për këtë shkak ne shiqojmë atë se çka kanë bërë UNMIK-u KFOR-i dhe IPV-s, për adresimin e çështjeve të sigurisë, lirisë së lëvizjes, qasjes në shërbime dhe punësim, të drejtat pronësore dhe civile, dhe të strukturave politike, përfshirë edhe adresimin e veprimeve të KFOR-it drejt reduktimit të punkteve kontrolluese statike.

Ne përshëndesim zhvillimet më të reja gjatë kësaj periudhe, siç është rasti i **krijimit të Bordit Këshillues të Komuniteteve (BKK) i përbërë nga agjencione të ndryshme,** dhe i cili do të duhej të ndihmoj krijimin e përgjigjes së unisuar të autoriteteve ndërkombëtare lidhur me çështjet e përshkruara në këtë dokument. Në vlerësimin e tetë, paraprak, të gjendjes së pakicave, UNHCR-ja dhe OSBE-ja kanë rekomanduar krijimin e një organi i cili “ do të siguronte që pas krijimit të Parlamentit të Kosovës, PSSP-ja të ketë informacione të besueshme mbi gjendjen e komuniteteve të pakicave, që ta udhëheqin atë gjatë ushtrimit të

pushtetit të tij ekzekutiv”¹. Mbledhja e parë e BKK-së është mbajtur në dhjetor të v.2001². BKK-ja është një organ i lartë konsultativ, funksioni i të cilit është të ofroj udhëzime mbi politikat, këshilla dhe rekomandime për PSSP-në, lidhur me stabilizimin dhe integrimin e pakicave në Kosovë. BKK-ja ka bërë një fillim të fuqishëm, duke orientuar politikat dhe në disa raste duke rekomanduar akcione konkrete për t’u ndërmarrur, lidhur me çështjet prioritare si kundër, lidhur me qasjen e pakicave në punësim dhe në mes tjerash ka bërë rekomandime edhe për masa të nevojshme të përmirësimit të lirisë së lëvizjes. BKK-ja ka parë edhe rolin e rëndësishëm të cilin e ka Zyra e PSSP-së për hapjen e dialogut me udhëhëqësinë politike të shqiptarëve të Kosovës, për qëllim të përfitimit të zotimeve politike në drejtim të integritetit dhe kthimit të pakicave. Mbetet të shpresohet se strukturat udhëheqëse politike në kuadër të IPV-s, do të vijnë theks të barabartë në çështjet e pakicave.

Ky vlerësim i përbashkët ofron analiza më të gjëra dhe të hollësishme të çështjes së **kthimit**. Kthimit të pakicave i është dhënë më shumë prioritet dhe përkushtim gjatë kësaj periudhe, si nga kthimet e lehtësuara dhe organizuara nga komuniteti ndërkombëtar, por dhe nga krijimi i Zyrës për Kthim dhe Komunitete në kuadër të Zyrës së PSSP-së (ZKK). Përpjekjet ndërmjet angjencive për të lehtësuar (organizuar) kthimin e një shkalle më të vogël, të pakicave të zhvendosura, përmes implementimit të projekteve të kthimit multi-sektorial, kanë arritur efektin e rëndësishëm të thyerjes së akullit. Megjithatë, përvojat nga procesi i kthimit të vitit 2001 kanë nënvizuar faktin se kthimi i organizuar në ambientet në të cilat ekziston nevoja për shkallë më të lartë të sigurisë, nuk është i përshtatshëm të realizohet në një shkallë më të lartë. Në të vërtetë, përderisa periudha e mbuluar me këtë raport, është dëshmitare e disa iniciativave të reja dhe të pa precedent të kthimit nëpër lokalitete specifike, problemet fundamentale shoqërore (siç është dialogu ndëretnik) dhe deficitet institucionale (siç është, mungesa e zbatimit të ligjit mbi të drejtat pronësore) kanë vazhduar të neglizhohen me të madhe. Shkaqet rrënjësore të pasigurisë, diskriminimit dhe tjetërsimit në mes grupeve etnike, të cilat pengojnë kthimin, mbeten që edhe më tej të adresohen. Synimi fundamental dhe i potencuar është ai, i të siguruarit se refugjatët dhe të zhvendosurit të kenë një **zgjedhje të lirë dhe të informuar**, lidhur me kthimin apo mos kthimin e tyre. Krijimi i opcionit për t’u kthyer, për një numër substancial të personave të zhvendosur, kërkon një arritjen e një progresi më kuptimplotë dhe përmbajtësor të çështjeve të mbuluara me këtë raport, respektivisht: të sigurisë, lirisë së lëvizjes, pronës, shërbimeve elementare, punësimin, pjesëmarrjes në strukturat civile dhe politike dhe dialogut ndëretnik. Të gjithë akterët e involvuar në procesin e kthimit, duhet të kenë kujdes të posaçëm që t’i shmangen politizimit të kësaj çështjeje.

Në fund, gjatë përshtatjes së analizave të çështjeve tematike dhe të mbuluara me këtë raport, ne gjithashtu kemi shqyrtuar gjendjen specifike të secilit **komunitet të pakicave** (përfshirë edhe shqiptarët e Kosovës, aty ku ata janë pakicë). Kjo analizë vazhdon të tregoj për përvojat e ndryshme dhe të llojllojshme për grupe të ndryshme etnike, posaçërisht lidhur me gjendjen e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes. Mirëpo, rezultatet prap vazhdojnë të tregojnë për problemet e përbashkëta dhe të cilat përjetohen, në një shkallë më të madhe apo më të vogël, nga të gjitha pakicat etnike, çoftë për shkak të diskriminimit, pamundësisë për të përdorur gjuhët e veta në mesin e komunitetit shumicë, apo për shkak të gjendjes së vazhdueshme të pozitës së dobësisë

¹ Që nga viti 1999, Ekipi Ad Hoc për Minoritetet ishte forumi i vetëm i përbërë nga agjenci të ndryshme dhe i cili i mbulonte në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjet e minoriteteve për tërë Kosovën. Ekipi i posaçëm, për shkak të natyrës ad hoc ishte i dobët dhe kishte më shumë karakter të forumit për shkëmbim të informacioneve se sa një rol të definuar të këshilldhënës, dhe mungesë të pjesëmarrjes së lartë nga UNMIK-u dhe strukturave tjera. Ky ekip fillimisht ishte kryesuar nga UNHCR-ja nën përgjegjësinë e Zyrës së Zëvendësimit të PSSP-së për Çështjet Humanitare/i dërguari special i UNHCR-së, dhe më vonë ishte bashkëkryesuar nga UNHCR-ja dhe OSBE-ja. Ekipi i posaçëm kishte ndërprerë punën në favor të krijimit të bordit këshues më të fortë, pra BKK-së.
² BKK-ja është kryesuar nga Zëvendësi Kryesorë i PSSP-së, ndërsa Zyra për Kthim dhe Komunitete në kuadër të UNMIK-ut i ka kryer punët e sekretarisë. Takohet në baza mujore. Si anëtare janë Zyra e PSSP-së përfshirë edhe ZKK-në, Çështjet Juridike, Komunitetet Politike, Departamenti i Informimit Publik dhe kryesuesit dhe zëvendësit e Shtyllës I të UNMIK-ut (Drejtimi dhe Polici), Shtyllës II (Administratës Civile, administratorët regional), Shtyllës III, (OSBE, Shtyllës IV (BE), pastaj policia e UNMIK-ut, KFOR-i, UNHCR-ja UNICEF-i, UNHCHR (Komesariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut), WHO, IOM, OCHA, ICRC (KNKK), dhe Këshilli Evropian. Deri më tani, komuniteti i OJQ-ve ndërkombëtare i ka vëzhguar mbledhjet përmes delegatit nga Aleanca për të Drejtat dhe Tolerancë (ADT).

ndaj dhunës. Shkalla e tanishme e zhvendosjeve në mesin e secilit prej këtyre grupeve, e gjithashtu largimet e familjeve të pakicave të Kosovës, tregon mbi faktet e kushteve tejet të vështira me të cilat ballafaqohen pakicat në Kosovë. Vetëm kur pakicat e Kosovës, do të kenë besim për të ardhmen afatgjatë, dhe kur e gjithë popullata e zhvendosur e Kosovës të ketë mundësinë e zgjedhjes për t'u kthyer në shtëpitë e veta, kur të risigurohet ndjenja dhe besimi i tyre për siguri, dhe mundësi të qasjes në institucione dhe të marrin pjesë në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të Kosovës, mbi baza të mos diskriminimit, atëherë do të jetë e mundur të thuhet se gjendja e pakicave në Kosovë është e pranueshme.

REKOMANDIMET

Ky vlerësim i përbashkët i OSBE-së dhe UNHCR-së, për pakicat është i shkruar për një publik të gjërë i cili përfshinë: autoritetet ndërkombëtare civile dhe ushtarake; vendim-marrësit, ligjdhënësit dhe punëtorët e administratës publike në kuadër të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPV); organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare; komunitetit për të drejtat e njeriut; OJQ-re ndërkombëtare dhe organizatat vendëse të shoqërisë civile dhe komunitetit të donatorëve. Anëtarët tjerë të këtij publiku janë qeveritë të cilat streghojnë refugjatët dhe personat e zhvendosur, përfshirë edhe autoritetet e FRJ-së, qeveritë e shteteve fqinje, por edhe shtetet e Evropës Perendimore. **Synimi ynë kryesorë është që përmes këtyre rekomandimeve, t'i ndihmojmë këta akterë në formulimin e strategjive dhe synimeve që kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes së pakicave dhe zgjidhjen e problemit të zhvendosjes.**

Ky vlerësim vjen në kohën e tranzicionit për Kosovën, me një rritje permanente të kompetencave në shumë fusha të qeverisjes dhe të bartura në zyrarët vendës të IPV-es, si në niveliet komunale poashtu edhe në ato qendrore. Së bashku me kompetencat vijnë edhe përgjegjësitë. Të gjitha rekomanimet vijuese, duhet të interpretohen nga të gjithë lexuesit, me një sens të qartë të rëndësisë fundamentale të **bërjes më të fortë dhe inkurajimit të strukturave të reja vendëse të qeverisjes, për të marrë përgjegjësinë** për çështjet të cilat tani i kanë nën kompetencë. Ka nevojë për shumë iniciativa, ndërsa këto të fundit, duhet të ndërmerren në kuadër të një partneriteti në mes të bashkësisë ndërkombëtare dhe vetë kosovarëve nga të gjitha përkatësitë etnike të cilat duhet të jenë të ndërgjegjshme për imperativin e kohës për të promovuar bartjen e përgjegjësiave në autoritetet vendëse.

Siguria dhe liria e lëvizjes

- Pasojat e heqjes së masave statike të sigurimit, duhet të përcjellen për së afërmi nga ana e autoriteteve ligjore dhe të tjerëve, ndërsa komunitetet duhet t'i diskutojnë në mes vete rezultatet e kësaj.
- Në të gjitha regjionet, KFOR-i duhet t'i diskutoj haptazi masat e tyre të sigurimit me policinë dhe të gjitha komunitetet, dhe duhet të përkrahë qasjen e hapur. Heqja e punkteve duhet të portretizohet si një përmirësim i lirisë së lëvizjes për të gjitha komunitetet, gjë që do të hapë rrugët për enklavat e izoluara.
- Restriksionet e imponuara nga KFOR-i dhe autoritetet tjera lidhur me lirinë e lëvizjes, posaçërisht kur këto zbatohen në bazë të përkatësisë etnike, duhet të jenë sa më të kufizuar në fushëveprimin e tyre, të sqaruar dhe të tërhiqen sa më shpejtë që është e mundur.
- Nevojitet një planifikim më i bashkërenditur në mes të KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut/SHPK-së. Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja duhet të përforcojnë rolin e tyre në mbrojtjen e sigurisë publike nëpër regjionet e pakicave dhe në lehtësimin e lirisë së tyre të lëvizjes për qëllim të marrjes së këtij roli nga KFOR-i.
- Gjatë bashkëpunimit me zyrarët komunal dhe liderët e komuniteteve, autoritetet ligjore duhet të dalin me një plan të adresimit të çështjeve të: ngacmimeve të vazhdueshme dhe të "shkallës së ulët" kundër pakicave, hedhjen e gurëve, dhe çështjes së inkorporimit të

masave parandaluese nga komuniteti dhe sanksionet (p.sh, ndjekjet penale dhe denimet). Në rast se ngacmimet kryhen nga të miturit, autoritetet duhet të intervenojnë së bashku me liderët e komuniteteve, zyrtarët e shkollave dhe prindërit për të ndryshuar sjelljet.

- Policia dhe autoritetet e drejtësisë, duhet t'i trajtojnë me prioritet krimet e drejtuara kundër lirisë së lëvizjes (siç janë, frikësimet dhe hedhjet e gurëve kundër këmbësorëve dhe veturave).
- SHPK-ja duhet të integrohet tërësisht, e posaçërisht SHPK-ja nga komunitetet e caktuara duhet të shkojë në regjione të komuniteteve tjera, dhe të përdorë më shumë patrullimet në përbërje të përzier dhe të integruar.
- Duhet të hartohet një plan veprimi për normalizimin e lëvizjes, si për përdorim të transportit publik poashtu edhe të atij privat, me pjesëmarrjen e forcave të sigurisë dhe mbrojtjes së rendit publik, komuniteteve vendëse dhe zyrtarëve komunal, ndërmarrjeve shërbyese të transportit, për të *punësuar dhe ofruar shërbime* për pakicat. Ky plan do të duhej të parashikoj reduktimin progresiv të prcjelljeve të profilit të lartë. Megjithatë, prëcjelljet nuk duhet të reduktohen nëse kjo nënkupton reduktimin e lirisë së lëvizjes.
- Të gjitha pakicat me liri të kufizuar të lëvizjes duhet që së paku, të kenë qasje në transportin e rregullt publik (si mundësi tjetër nga iniciativat private si zgjidhje të vetme), pa marrë parasysh se kjo e fundit a është fitim-prurëse apo jo.
- Për zgjidhjen e çështjes së tabelave të regjistrimit, nevojitet marrëveshja në mes të Institucioneve të Përkohëshme të Vetëqeverisjes, UNMIK-ut dhe autoriteteve të Beogradit.

Drejtësia

- Si nga UNMIK-u, poashtu edhe nga autoritetet e Beogradit duhet të ndërmerren hapa drejt anulimit të sistemit paralel të gjykatave. Preferohet absorbimi i negociuar i tyre dhe stafit të tyre, në kuadër të sistemit të UNMIK-ut, së bashku me një deklaram të qartë të autoriteteve të Beogradit se këto gjykata nuk janë më legjitime dhe se banorët e Kosovës duhet t'i shfrytëzojnë gjykatat e UNMIK-ut.
- Duhet të ndërmerren masa të veçanta nga ana e UNMIK-ut për të siguruar, jo vetëm që të punësohen pakicat nga ana e sistemit gjyqësor, por edhe, së paku në fillim, të krijojnë mundësi për të bërë një gjë të tillë, përfshirë edhe masat e veçanta të sigurimit dhe përcjelljes.
- Duhet të korrigjohet praktika e zakonshme e shqyrtimit të rasteve të pakicave vetëm nga gjykatësit pjesëtarë të pakicave dhe gjykatësit ndërkombëtarë, dhe në të njëjtën kohë, duhet të ndërpritet praktika që gjykatësit pjesëtarë të pakicave, të thirren vetëm për rastet që kanë të bëjnë me pjesëtarë të pakicave. Në vend të parë, kjo gjë duhet të organizohet nga ana e kryetarëve të gjykatave. Në vend të kësaj, të gjitha rastet senzitive që përfshijnë, gjykatësin dhe të pandehurin nga përkatësitë e ndryshme etnike, duhet të përjcellen për së afërmi nga OSBE-ja dhe të tjerët. Secili gjykatës nga cilado përkatësi etnike, i cili shfaqë njëanshmëri apo diskriminim, duhet t'i nënshtrohet procedurës disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës.
- Rastet e suksesshme të arrestimit, gjykimit dhe ndjekjes penale për krimet me motive etnike, duhet të publikohet gjerësisht nga ana e Departamentit të Drejtësisë, nga mediat dhe të tjerët të cilët janë të involvuar në sistemin juridik.
- Departamenti i Drejtësisë duhet të hapë një zyre të gjykatës së Ferizajit, në Shtërpçë.
- Departamenti i Drejtësisë, së bashku me ndihmën e ndonjë organizate të interesuar, do të duhej të dizajnoj dhe implementoj një fushatë publike e cila do të vënte nën shënjestër pakicat, për qëllim të shpërndarjes së informatave mbi sistemin civil të drejtësisë.

Shkollimi

- UNMIK-u, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (MASHK), në bashkëpunim me KFOR-in, policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në duhet të zhvilloj dhe siguroj financimin e një plani gjithëpërfshirës që do të përmirësonte gjendjen e sigurisë dhe qasjen e studentëve të pakicave në tërë Kosovën, përfshirë edhe një plan të gjërë për transportimin shkollor të pakicave.
- Plane të ngjajshme duhet të krijohen për përmirësimin e kushteve fizike të shkollave, furnizimin me libra dhe mjete shkollore për studentët pa pagesë, dhe krijimin e një programi, brenda aktiviteteve të shkollës, për trajnimin e mësuesve pjesëtarë të pakicave.
- UNMIK-u dhe MASHK-s duhet të caktojnë prioritetet mbi integrimin e sistemit arsimor. Përmes hapit të parë, duhet të zgjidhen çështjet e ngritura mbi juridikcionin e përbashkët në mes UNMIK-ut/MASHK-s dhe Ministrisë së Arsimit të FRJ-së, të cilat kanë një efekt të dëmshëm për të drejtat e fëmijëve në shkollim. Duhet të arrihet standardizimi i planprogramit arsimor dhe i të gjitha praktikave administrative, përfshirë edhe ato të punësimit.
- UNMIK-u dhe MASHK-s, duhet të konsultohen me ekspertët për çështje të shkollimit të cilët merren me çështjet e shkollimit të romëve, dhe të cilët vijnë nga shtetet evropiane, për qëllim të: a) zhvillimit të programit të veçantë për adresimin e nevojave arsimore të përmirësuar, b) krijimit të parakushteve për inkurajimin, dhe si mjet të fundit, të kërkohet nga prindërit që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollën e mesme, dhe c) të shqyrtohet se në çfarë mase mund të inkorporohet gjuha rome në kuadër të planprogramit arsimor.
- Duhet të analizohen modele të ndryshme të integruara shkollore, dhe praktikat më të mira duhet të përdoren më gjerësisht.

Pnësimi

- Ministria e Shërbimeve Publike duhet më fuqimisht të pomovoj politikën e veprimit afirmativ (jo vetëm të punësimit sipas përqindjeve) në procesin e punësimit të pakicave në sektorin publik. Më tutje, i gjithë legjislacioni pozitiv i cili parashikon një numër të caktuar (përqindje) të punësimit, duhet të rishiqohet për t'u siguruar se ky numër të jetë proporcional me interesin të cilin shteti dëshiron ta mbroj, për shembull, të ofroj *barabarësi efektive* për punësimin e pakicave.
- IPV-s duhet të rivlerësojnë sistematikisht të gjitha praktikat e punësimit në sektorin publik, për të siguruar, se ato janë efektive si në aspektin teorik poashtu edhe në atë praktik prë të siguruar barabarsinë.
- Të gjitha procedurat e rënda përmes të cilave kandidatët nga rradhët e pakicave duhet t'i kalojnë për të aplikuar, të gjitha vendimet mbi punësimin duhet të vlerësohen nga Ministria e Shërbimeve Publike dhe nëse ato nuk funksionojnë si duhet, duhet të ndërmerren masa për sigurimin e mjeteve efikase juridike për secilin person që pëson nga praktikat diskriminuese të punësimit.
- Të gjithë punëtorët e shërbimit civil, duhet të stërviten për të pasur mundësi të identifikojnë sjelljen diskriminuese dhe për të implementuar politikat dhe procedurat e çrrënjësjes së kësaj sjelljeje në kuadër të zyrave të tyre gjegjëse. Më tutje, urdhëresat administrative duhet t'i shpërndahen të gjithë shërbimit civil, ndërsa duhet të zhvillohen stërvitje obligative për t'u siguruar se të gjithë punëtorët e shërbimit civil, të kuptojnë detyrën e tyre ligjore për t'ju përmbajtur standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e në veçanti nëse ato kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë të komuniteteve të pakicave.
- Në Kosovë ekziston nevoja për një ligj gjithëpërfshirës dhe kundër diskriminimit. Duhet të miratohet propozimi i OSBE-së për dekretimin e një katalogu ligjesh kundër diskriminimit në Kosovë, pasi që një ligj i tillë do të fuqizonte ligjin e tanishëm mbi diskriminimin duke e harmonizuar të njëjtin me standardet dhe ligjet evropiane kundër diskriminimit. Ky ligj ka për qëllim, promovimin e uniformizmit gjatë gjyqimit të rasteve, dhe parashikimin e mejteve ligjore juridike për viktimat e shumicës së llojeve të

diskriminimit, por edhe, sanksioneve efektive, proporcionale dhe parandaluese për t'ju përgjigjur dhunës. Kishte me qenë ideale që ky ligj të miratohet nga Parlamenti.

Shëndetësia

- Autoritetet shëndetësore duhet të zhvillojnë një sistem multietnik të kujdesit sekondar shëndetësor, dhe duhet të zbatojnë rregullin kardinal të profesionit mjekësor e që është, se mjetët duhet të trajtojnë çdo pacient pa marrë parasyshë origjinën e tyre raciale apo etnike.
- Ministria e Shëndetësisë, duhet të injoroj sistemet shëndetësore paralele dhe të paqëndrueshme në njërën anë, dhe duke siguruar qasje të barabartë për secilin, pamarrë parasyshë përkatësinë etnike, në kujdesin shëndetësor.
- Ministria e Shëndetësisë duhet të siguroj se informatat lidhur me kujdesin dhe lehtësitë për kujdes shëndetësor, të arrijnë deri te pjesëtarët e komuniteteve të pakicave. Kjo Ministri duhet të ndërmerr një fushatë të informimit për pjesëtarët e komuniteteve të romëve, ashkalive dhe egjiptasve.

Mirëqenia sociale

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të pëcjellë për së afërmi efektet e kërkesës për “regjistrim të sërishëm” në skemën e ndimës sociale. Duhet të braktiset çdo praktikë e cila në mënyrë të tërthortë konsiderohet diskriminuese (p.sh, pakicat, pa lirinë e lëvizjes, kanë më shumë probleme që t'i plotësojnë kushtet). Detyra themelore e autoriteteve për sigurimin se secili person mund të jetoj me dinjitet dhe të ketë mjete të mjaftueshme materiale për këtë, duhet të ketë prioritet. UNMIK-u duhet të përmirësoj transparencën me organizatat humanitare të cilat përcjellin qasjen e pakicave.
- Qendrat për Punë Sociale duhet të rrisin koordinimin dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë në mes të punëtorëve të cilët punojnë në regjionin e shumicës dhe atyre të cilët punojnë në regjionet e pakicave.

Banimi

- Udhëzimet për rindërtimin e shtëpive, duhet të kenë peshë ligjore. Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor (MAPH), duhet të hartoj ligje për miratim nga Parlamenti i Kosovës, duke përkufizuar kriteret jo diskriminuese të ndarjes (alokimit), proceset transparente të përzgjedhjes dhe mekanizmat të cilët mundësojnë dhënjën e përgjegjësisë dhe ankesës.
- Procesi i bartjes së përgjegjësisë në komuna, duhet të shoqërohet edhe me krijimin e një mekanizmi të përkohshëm vëzhgues dhe efektiv, i cili përfshinë përgjegjësinë e drejtorive dhe komisioneve për banim të komunave ndaj UNMIK-ut dhe MAPH-r, që kryhet përmes raportimit mujor.
- Për shkak të mungesës së numrave (kuotës) gjegjës në udhëzimet për rindërtimin e shtëpive për pakicat për vitin 2002, donatorët duhet të sigurojë se OJQ-të e tyre implementuese t'i plotësojnë qëllimet e duhura, gjë që mund të realizohet përmes konsultimeve participuese, dhe të cilat përfshijnë zyrtarët e komuniteteve.
- OJQ-të, si partnerë implementues të Komisioneve Komunale të Banimit (pra organe shtetërore) duhet të mbahen të përgjegjshme për sjelljet e tyre para KKB-it dhe Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor.
- Kriteret për rindërtim duhet të kërkojnë ndarjen e ndihmës në bazë të pozitës së dobësisë, që shkakton efekte të ngajshme për secilin etnitet. Për shembull, kriteri për rindërtim duhet të kërkoj të rindërtohet një numër të themi 20% i të gjitha shtëpive, të pakicave dhe të tjerëve, të vlerësuara si kategoria IV dhe V. Duhet të gjinden resurse tjera për derisa të arrihet përqindja e afërt e shtëpive të rindërtuara në komunitetet e pakicës dhe shumicës.

- Nevojat imediate të banimit dhe rindërtimit, në vendet e pakicave të cilat janë të zhvendosura brenda Kosovës, duhet të adresohen dhe për të gjitha rastet ku rindërtimi paraqet si pengesë kryesore për kthim, përfshirë edhe ata persona të zhvendosur të cilët janë kthyer nga jashtë me vetiniciativë në familjet nikoqire të stërngarkuara me njerëz.
- Duhet të krijohet një mekanizëm financues që i përgjigjet nevojave të rindërtimit për kthimin spontan dhe të organizuar të pakicave. Financimet duhet të llogarisin dhe shpenzimet shtesë të projekteve të kthimit, dhe të shoqëruara me projektet e balancuara të komuniteteve fqinje të shumicës.

Prona

- Gjykimet pronësore-juridike duhet të zënë vend prioritar në rendin e ditës për financim nga Bugjeti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) dhe donatorët, në kontekst të stabilizimit dhe kthimit të pakicave. Resurset duhet t'i ndahen Drejtoratit për Çështje Pronësore-Banesore (DÇPB) dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB) për të mundësuar a) dërgimin efektiv të njësive mobile në regjionet e pakicave, b) ngriten e vetëdijësimit, c) pranimin dhe procedimin e kërkesave, përfshirë edhe vendim-marrjen e KKPB-së, dhe d) qeverisjen e pronës nën administrimin e DÇPB-së, përfshirë edhe mbrojtjen efikase të pronës së braktisur për t'ju shmangur uzurpimeve të sërishme dhe dëmtimeve.
- DÇPB-ja duhet të përshpejtoj angazhimet drejt delegimit të kompetencave në komunat e afta, përfshirë edhe identifikimin dhe iniciimin e procesit të delegimit në komunat përkatëse.
- Sa më shpejtë që është e mundur, duhet të hapet një zyre e DÇPB-së në Prizren. Aty ku shfaqet nevoja kjo drejtori duhet të hapë zyra satelite, të përkohshme apo permanente.
- Duhet të rritet numri i pjesëtarëve të pakicës në kuadrin e stafit të DÇPB-së, për të lehtësuar qasjen e pakicave.
- Secili zyrtarë i komuniteteve lokale, duhet të jetë plotësisht i vetëdijshëm për mekanizmat e DÇPB-së.
- Nga UNMIK-u dhe IPV-s duhet të ketë prioritet puna drejt një kadastrit të ri dhe funksional. Duhet të krijohen masa të përkohshme mbrojtëse për mbrojtjen e të drejtave pronësore të cilat ekzistojnë tani. Taksat regjistruese duhet të përshtaten sipas pozitës së dobësisë, dhe këto iniciativa të publikohen për qëllim të lehtësimit të regjistrimit të të drejtave pronësore.
- Një akomodim i arsyeshëm duhet të bëhet nga të gjitha autoritetet të cilat merren me çështjet e pronësisë, dhe për rrethanat unike të pakicave të caktuara. Për shembull, romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve me të drejta të pranuar pronësore, duhet t'ju ofrohet ndihma si çështje prioritare për të konstatuar pronësinë apo posedimin e pasurisë relevante. Një vëmendje imediate duhet t'i kushtohet kontesteve të llojllojshme pronësoro-juridike në mes të këtyre komunitete dhe komunave.
- Parlamenti dhe UNMIK-u duhet të plotësojnë zbrastësirën ligjore në legjislacionin mbi pronën, të bëjnë ligjin të qartë, dhe ta përshtasin me realitetin e ri të kohës (respektivisht ekonominë e tregut)

Zgjedhjet

- OSBE-ja duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë përcjelljes së pjesëmarrjes në procesin zgjedhor për zgjedhjet komunale që është paraparë të mbahen në vjeshtë të vitit 2002, përfshirë edhe procesin e regjistrimit³. Fushatat informative duhet të identifikojnë dhe të arrijnë deri te elektorati në Serbi, Mal të Zi dhe IRJM me një senzitivitet më të shtuar sa i përket gjuhës (përfshirë edhe materialin në gjuhën rome dhe gjuhë të tjera). Një vëmendje

³ Bashkësia ndërkombëtare duhet t'i përmirësoj përpjekjet për sigurimin e zbatimit të dokumentit të Kopenhagës, i cili präcakton standardet për shansa të barabarta për subjektet politike gjatë fushatës. Lexo dokumentin e Takimit të Kopenhagës në konferencën për dimenzionin human të CSCE, neni 7.7 viti 1990

e veçantë duhet t'i kushtohet sigurimit se komunitetet e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve të jenë më mirë të informuara për procesin e regjistrimit të votuesve dhe lokalitet e qendrave të regjistrimit të votueseve, posaçërisht ato jashtë territorit të Kosovës.

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe OSBE-ja duhet të sigurojnë një shkallë më të lartë të përfshirjes së vëzhguesve nga pakicat jo-serbe gjatë zgjedhjeve të ardhëshme.
- OSBE-ja duhet të formoj ekipe të terrenit për zgjedhjet e ardhëshme komunale, të cilat do t'ia dedikojnë punën dhe kohën në mënyrë proporcionale komuniteteve të ndryshme të pakicës.
- Mungesa e lirisë së lëvizjes do të ketë ndikim më të madh në zgjedhjet komunale se sa që kanë pasur gjatë zgjedhjeve parlamentare, për shkak se janë 30 kuvende komunale të cilat duhet të zgjedhen, ndërsa partitë nga komunitetet e pakicave duhet të kenë mundësi të lëvizin lirish në mesin e elektoratit të vet gjatë fushatës. Përpjekje të vendosura duhet të ndërmerren nga OSBE-ja dhe të tjerët që janë të involvuar në procesin e zgjedhjeve, për të siguruar qasjen e atyre me liri të kufizuar të lëvizjes, përfshirë edhe qasjen e barabartë të shfrytëzimit të mediave për fushatë.

Pjesëmarrja në strukturat civile dhe politike

- Nga të gjitha komunat duhet të kërkohet që sa më parë të formojnë Komisionet për ndërmjetësim dhe komunitete, dhe të raportojnë për punën e tyre.
- Mund të shfaqet nevoja që PSSP-ja të ndërmerr masa të veçanta të sigurimit të pjesëmarrjes së pakicave, nëse pas zgjedhjeve komunale të vjeshtës 2002 në Kosovë, rezultatet tregojnë për një nën-përfaqësim të pakicave në kuadër të Kuvendeve Komunale.

Toleranca dhe pajtimi ndëretnik

- Një fushatë mediale duhet të publikoj shembujt pozitiv të bashkëpunimit ndëretnik në mesin e anëtarëve të Kuvendeve Komunale, por edhe udhëheqësve të instancave komunale, për qëllim të promovimit të tolerancës në të gjitha instancat e shoqërisë.
- Duhet t'i jipet prioritet stërvitjeve dhe shkollimit të ligjvënësve në kuadër të Parlamentit, por edhe atyre të cilët implementojnë politikat sikurse janë, punëtorët e shërbimit civil, për të siguruar se mundësitë dhe politikat promovuese të pajtimit dhe dialogut ndëretnik, janë të rëndësishme qendrore dhe jo marginale për punën e tyre.
- Shoqëria civile e Kosovës duhet të përkrahet më shumë për të promovuar të drejtat e njeriut, dialogun dhe tolerancën ndëretnike dhe të përcjellin porosinë e tyre përmes mediave dhe infomimit masiv.
- Agjencionet për dizajnimin e projekteve të zhvillimit ekonomik, dhe donatorët të cilët financojnë këto projekte, duhet të përfshijnë komponentet e bashkëpunimit ndëretnik për të ndihmuar ndërtimin e mirëbesimit përmes realizimit të interesave të përbashkëta. Duhet gjithashtu të përkrahen dhe zhvillohen iniciativat e ndihmesës së aktiviteteve rinore ndëretnike, siç janë: ngjarjet sportive, koncertet dhe aktivitetet tjera kulturore të cilat janë stimuluese dhe interaktive.
- Perspektiva e Komisionit të pajtimit dhe të së vërtetës, duhet të diskutohet në mënyrë të hapur nëpër media, dhe i kryesuar nga IPV-s dhe UNMIK-u.

Kthimi

- Duhet të pranohet roli qendror i krijimit të kushteve për kthim përmes dialogut dhe ndërtimit të mirëbesimit ndëretnik. Plani për kthim, i cili parashikon një kthim substancial, por i cili bishtëron procesin e dialogut, duhet të menjanohet. Duhet t'i jipet prioritet cilësisë dhe përmbajtjes, e jo numrit të kthimeve të para, për qëllim të krijimit të një baze solide për një proces kuptimplotë.

- Planet e sigurisë duhet të harmonizohen me përpjekjet në instancat civile për stabilizimin e raporteve ndëretnike përmes dialogut dhe ndërtimit të mirëbesimit. Nevojitet një bashkëpunim më i madh në mes të agjencioneve ushtarake dhe civile në definimin më të mirë të kornizës konceptuale të planeve të sigurisë pas kthimit (përfshirë reduktimin në faza të masave të sigurimit në vendbanimet e të kthyerve). Planet e sigurisë duhet të marrin parasyshë perceptimet e krijuara nga masat strikte të sigurimit në mesin e të gjitha komuniteteve, dhe duhet të sigurojnë se barrierat fizike dhe psikologjike në mes të pakicave të kthyerë dhe komunitetit të shumicës të mos shëndrrohen në barrikadime të mëtejshme. Duhet të shmangen kthimet në ambientet e stër-militarizuara, të cilat përforcojnë veçimin (ndarjen) fizik(e) dhe psikologjik(e).
- Një vëmendje e barabartë duhet t'i kushtohet refugjatëve dhe të zhvendosurve të përkatësisë rome, ashkallike dhe egjiptase, por edhe çështjes së shqiptarëve të Kosovës të zhvendosur nga regjionet me shumicë serbe. Çështja e të zhvendosurve pjesëtarë të të gjitha grupet etnike, duhet të adresohet në mënyrë simultane, megjithatë të gjith akterët duhet të pranojnë faktin se progresi i kthimit, varet nga ndërlikueshmëria e situatës politike/sigurisë në regjionin konkret.
- Strukturat e sapo të krijuara të IPV-s duhet të angazhohen në përkrahjen e procesit të kthimit, ashtu siç edhe e parshikon Korniza Kushtetuese. Bashkësia ndërkombëtare duhet të siguroj që përkrahja t'i ofrohet IPV-s për iniciimin e dialogut politik dhe procesit të arritjes së koncensusit mbi çështjen e kthimit.
- IPV-s dhe bashkësia ndërkombëtare, e në veçanti UNMIK-u dhe donatorët, duhet të trimërojnë komunat që të angazhohen në mënyrë konstruktive në procesin e planifikimit të kthimit, duke siguruar shërbime komunale nëpër regjionet në të cilat realizohet kthimi dhe duke ushtruar një lidhshmëri pozitive karshi raporteve ndërmjet komuniteteve. Komuniteti i donatorëve duhet të merr parasyshë ofrimin e nxitjeve pozitive prë komunat të cilat përkrahin integrimin dhe kthimin e pakicave.
- Nevojitet shpërndarja e informacioneve mbi të dhënat e sakta të procesit të kthimit dhe çështjeve që kanë të bëjnë me (të drejtat individuale, sundimi i së drejtës, etj) përmes mediave Kosovare dhe krijuesve tjerë të opinionit publik. Duhet t'i kushtohet një vëmendje e posaçme përdorimit të mediave karshi çështjes së kthimit të pakicave për të siguruar një mbulim të drejtë dhe të përgjegjshëm të ngjarjeve.